REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno/Prodato / Recieved/Delivery		10 - 12 - 201 8	viti god year
Organ./Njesia / Organ./Jedinica / Org./Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot.No:	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	7524/2018		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.690/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Lela Petković- kryetare, Hajzer Salihu dhe Shkëmb Manaj-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.690/2018 të datës 25.10.2018 me numër protokolli 6344/2018 të parashtruar nga ankuesja Safete Selmani, kundër Vendimit me numër të protokollit 2018/KZKA-01 të datës 25.10.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.690/2018 me numër protokolli 6344/2018 e datës 25.10.2018 e parashtruar nga ankuesja Safete Selmani.

II. Shfuqizohet Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me numër të protokollit 2018/KZKA-01 të datës 25.10.2018 si dhe Vendimi me numër të protokollit KD/07/2018 i datës 18.09.2018 i Komisionit Disiplinor.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që nga dita e pranimit të këtij vendimi që brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë zbatimin e tij si dhe kompensimin e pagës të 1/3 për dy muaj.

IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses Safete Selmani, e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Akt emërimit të datës 04.03.2016 në pozitën "Menaxhere e Personelit", në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Udhëheqësi i drejt për drejtë i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 31.08.2018 nëpërmjet e-mailit zyrtar, ka kërkuar nga Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore që të filloj procedura disiplinore ndaj ankueses Safete Selmani, për shkak: *"të shkeljes disiplinore në kuptim të nenit 66.4 të Ligjit Nr.03/L-149 dhe Nenit 6 të Rregullores Nr.04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin*

civil, të cilën, pas një shqyrtimi të kujdesshëm, në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ në përputhje me Nenin 11.5 të Rregullores, kam vendosur të cilësoj si shkelje të rëndë serioze".

Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 18.09.2018 me numër të protokollit KD/07/2018 merr vendimin me të cilin vendim ankueses Safete Selmani i shqiptohet masa disiplinore ***"pezullim nga marrëdhënia e punës për dy muaj dhe gjatë periudhës së pezullimit i ndalohet 1/3 e rrogës",*** në pikën e dytë dhe të tretë të dispozitivit të vendimit të Komisionit Disiplinor përcaktohet se pezullimi i marrëdhënies së punës hyn në fuqi në ditën e marrjes së këtij vendimi dhe se obligohet Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore, që në pajtim me pikën 1 të këtij vendimi të zbatoj procedurat e pezullimit dhe njëkohësisht t`ia ndërpresë znj.Selmani qasjen në pronën intelektuale të AAC-së gjatë periudhës së pezullimit.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e datës 18.09.2018 me numër të protokollit KD/07/2018 të Komisionit Disiplinor, me datë 20.09.2018 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 23.10.2018 merr vendimin me numër të protokollit 2018/KZKA-01 me të cilin vendim aprovohet pjesërisht ankesa e ankueses Safete Selmani, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor dhe vërtetohet masa disiplinore e pikës 1 të Vendimit të Komisionit Disiplinor të AAC-së të datës 18.09.2018 me numër të referencës KD/07/2018 lidhur me pezullimin nga marrëdhënia e punës për dy muaj dhe ndalesë të 1/3 të rrogës.

Ankuesja Safete Selmani, e pa kënaqur me vendimin me numër të protokollit 2018/KZKA-01 të datës 23.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 25.10.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 6344/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 25.10.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 23.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 18.09.2018 i Komisionit Disiplinor; E-maill-at e datave: 21.06.2018; 26.06.2018; 04.07.2018; 09.07.2018; 04.09.2018; 03.09.2018; 31.08.2018; 30.08.2018; 31.08.2018; 22.06.2018; Elaborimi zyrtar lidhur me komunikimin për Vendimin Nr.Ref.03/2018 i datës 21.06.2018; Procesi i klasifikimit të vendeve të punës dhe vendosja e nëpunësve civil në pozita dhe grada e datës 21.01.2016; Letër Qarkore lidhur me konkurset për punësim; Elaborimi i shkurtër për vendimin nr.ref. 03/2018 i datës 21.06.2018 Vendimi me Nr.Ref.03/2018 i datës 21.06.2018; Akt emërimi i ankueses i datës 04.03.2016; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 07.09.2018; Procesverbali i datës 01.10.2018 dhe 12.10.2018 i Komisionit për Ankesa; Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankueses Safete Selmani **është e bazuar.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit dhe ankuesja ka konstatuar se, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 31.08.2018 nëpërmjet e-mailit zyrtar, ka kërkuar nga Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore që të filloj procedura disiplinore ndaj ankueses Safete Selmani, për shkak: *"të shkeljes disiplinore në kuptim të nenit 66.4 të Ligjit Nr.03/L-149 dhe Nenit 6 të Rregullores Nr.04/2011 për procedurat disiplinore në*

shërbimin civil, të cilën, pas një shqyrtimi të kujdesshëm, në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ në përputhje me Nenin 11.5 të Rregullores, kam vendosur të cilësoj si shkelje të rëndë serioze".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dëshmitë e dosjes ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, i ankueses me rastin e inicimit të rastit në Komision Disiplinor, ka dyshuar se ankuesja Safete Selmani ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës dhe se Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil me rastin e marrjes së vendimit me numër KD/07/2018 të datës 18.09.2018 ankueses i shqiptohet masa e rëndë disiplinore *"pezullim nga puna dhe ndalim i 1/3 të rrogës për një periudhë për dy muaj"*, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar në mënyrë të qartë se masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit më numër 2018/KZKA-01 të datës 23.10.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L–149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: ***"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës",*** dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: ***"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses Safete Selami;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.690/2018

Lela Petković
Kryetare e Kolegjit

Valentina Kaçandolli Bekteshi
Procesmbajtëse